

RREGULLAT E KONKURISIT TË VIZATIMIT PËR FËMIJË NË PENZIJA.MK

“Mburo paratë e tua, siguro të ardhmen tënde”

Organizatorë të konkursit të vizatimit për fëmijë

Neni 1

Organizatorë të konkursit të vizatimit për fëmijë janë::

1. **Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional MAPAS**, me zyra në rr. Slavko Janeski 100, 1000 Shkup me NIPT 5675162 dhe NT 4030002455375,
2. **Shoqëria aksionare për administrimin e fondeve pensionale vullnetare dhe të obliguara Fondi Pensional Sava SH.A Shkup**, me seli në rr. Nënë Tereza nr. 1, 1000 Shkup, me NIPT 5989434 dhe NT 4030005551006,
3. **“KB Prvo” shoqëria aksionare për administrimin e fondeve pensionale vullnetare dhe të obliguara SHA Shkup** me seli në rr. Metropolit Teodosij Gologanov nr. 6, 1000 Shkup, me NIPT 5990815 dhe NT 4030005550662,
4. **Shoqëria aksionare për administrimin e fondeve pensionale vullnetare dhe të obliguara Triglav Penzisko Drustvo SHA Shkup** me seli në Bul. 8 Shtatori nr. 18, kati 2, 1000 Shkup me NIPT 7344228 dhe NT 4057019545071 dhe

Aktivitetet për realizimin e konkursit për vizatim për fëmijë do të realizohen në bashkëpunim me agjencinë e marketingut PIKSEL SHPK.

Qëllimi i konkursit të vizatimit për fëmijë

Neni 2

Qëllimi i këtij konkursi është të inkurajojë fëmijët që në mënyrë kreative të përfaqësojnë dhe të kuptojnë rëndësinë e pensionit, të arrijnë të kuptojnë detyrimin dhe nevojën për të kursyer për pension, të kuptojnë nevojën për të marrë vendime të duhura financiare, të rëndësishme për të ardhmen e tyre dhe të mësojnë se sa e rëndësishme është të kursesh për të ardhmen dhe të investosh paratë në mënyrën e duhur.

Territori

Neni 3

Konkursi i vizatimit për fëmijë do të organizohet dhe do të zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

E drejta për pjesëmarrje dhe rregullat për pjesëmarrje

Neni 4

Të drejtë për pjesëmarrje në konkursin e vizatimit për fëmijë kanë të gjithë fëmijët që janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut në moshë prej 4 deri në 14 vjeç. Fëmijët e punonjësve të Organizatorëve dhe fëmijët e punonjësve të agjencisë së marketingut Pikel, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në konkursin e vizatimit për fëmijë. Vizatimet e fëmijëve me temën **"Mburo paratë e tua, siguro të ardhmen tënde"** së bashku me të dhënat për fëmijën - pjesëmarrës në konkurs dhe prindin/kujdestarin:

- Emri dhe mbiemri i fëmijës;
- Vendi i banimit (komuna/fshati/qyteti);
- Emri dhe mbiemri i prindit/kujdestarit bashkë me vendin e banimit dhe
- Numri i telefonit për kontakt i prindit/kujdestarit.

të dërgohen në mënyrë elektronike në e-mail adresën gmw2024konkurs@gmail.com me titull “Për konkursin e vizatimit në faqen **penzija.mk**” deri më 18.03.2024.

Vizatimet që do të dërgohen në mënyrë elektronike duhet të skanohen bukur ose të fotozohen me rezolucion të shkëlqyer. Vizatimet nuk duhet të përpunohen ose të krijohen në mënyrë dixhitale duke përdorur aplikacione elektronike.

Vizatimi origjinal duhet të ruhet deri në përfundim të konkursit të vizatimit dhe nuk duhet të dërgohet me postë.

Çdo vizatim duhet të jetë individual, pra të vizatohet nga një fëmijë, jo nga një grup fëmijësh. Në konkurs mund të marrin pjesë vizatime në çdo teknikë, formë dhe madhësi.

Në fazën e parë, një juri e përzgjedhur nga Organizatorët do të vlerësojë të gjitha vizatimet me të drejtë pjesëmarrje në datat 18.03.2024 dhe 19.03.2024 dhe do të bëjë një përzgjedhje të ngushtë të vizatimeve. Në fazën e dytë do të vlerësohen vetëm vizatimet e përzgjedhura.

Nëse vizatimi hyn në fazën e dytë të vlerësimit, do të publikohet publikisht në rrjetet sociale dhe në faqen **penzija.mk**, ku për të do të mund të votohet menjëherë.

Votimi do të zhvillohet nga data 20.03.2024 deri më 24.03.2024 me një reagim pozitiv ndaj vizatimit të publikuar.

Përzgjedhja e vizatimeve që do të kenë numrin më të madh të reagimeve pozitive në rrjetet sociale në kategoritë përkatëse do të jenë fituesit e çmimeve dhe do të shpallen publikisht, së bashku me njoftimin për ndarjen e çmimeve.

Dërguesi do të kontaktohet nga Organizatorët për të dorëzuar vizatimin origjinal për konfirmim. Nëse dërguesi nuk e dorëzon vizatimin origjinal brenda afatit të caktuar, vizatimi do të skualifikohet.

Konkursi do të jetë në tre kategori: fëmijë nga 4 - 7 vjet, fëmijë nga 7 - 10 vjet dhe fëmijë nga 11 - 14 vjet. E drejta e pronësisë për të gjitha vizatimet e paraqitura që do të hyjnë në fazën e dytë të vlerësimit i përket Organizatorëve.

Çmimet

Neni 5

Çmimet e ofruara nga organizatori janë si më poshtë:

Çmimi i parë – 3 X Tabela për vizatim

Çmimi i dytë – 3 X Kurs tremujor për vizatim

Çmimi i tretë - 3 X Pako me produkte për vizatim (ngjyra, markera, ngjyra uji, tempera, furça, blloqe, etj.)

Marrja e çmimeve

Neni 6

Fituesit e çmimeve do të mund të marrin çmimet e tyre personalisht, në prani të një prindi/kujdestari në një datë të përcaktuar në shpalljen publike të çmimit.

Çmimet që nuk do të merren në ditën e dhënies së çmimit, fituesi/kujdestari i tij ka të drejtë t'i marrë brenda 60 ditësh nga dita e shpalljes, në ambientet e agjencisë së marketingut çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 16:00 duke paraqitur një dokument identifikimi.

Masat teknike dhe organizative për të siguruar fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale nga pjesëmarrësit në konkursin e vizatimit për fëmijë

Neni 7

Për të gjitha vizatimet e bashkangjitura, duhet të zbatohen masat teknike dhe organizative të klasifikuara në nivelin bazë. Të dhënat personale (emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe numri i telefonit të kontaktit) përpunohen për të gjithë dërguesit në bazë të pëlqimit të tyre sipas nenit 12 të këtyre rregullave.

Publikimi i të dhënave personale të dorëzuesve të vizatimit dhe dorëzuesve të vlerësuar të vizatimit

Neni 8

Organizatori i konkursit të vizatimit do t'i publikojë publikisht të gjitha vizatimet që plotësojnë kushtet e këtyre rregullave, si dhe vizatimet e shpërblyera në ueb faqen e penzija.mk së bashku me të dhënat personale të dërguesit (emri, mbiemri, mosha dhe qyteti i banimit). Vizatimet e shpërblyera do të publikohen në Facebook, në faqen e penzija.mk dhe në profilin e Instagramit të penzija.mk, së bashku me të dhënat e dërguesve (emri, mbiemri, mosha dhe qyteti i banimit). Qasje në këto të dhëna do të kenë të gjithë ata që vizitojnë ueb faqen e penzija.mk, faqen në Facebook të penzija.mk dhe profilin e Instagramit të penzija.mk. Janë siguruar masat teknike në lidhje me publikimin e të dhënave personale të dërguesve në mënyrë që me futjen e emrit dhe mbiemrit të dërguesit (subjekti i të dhënave personale) dhe kërkimit e search engines si Google Search ose Yahoo, të mos ketë mundësi të marrë të dhënat për subjektin nga përmbajtjet që janë të vendosura në ueb faqen dhe faqen në Facebook të penzija.mk.

Mënyra e informimit të subjekteve të të dhënave personale

Neni 9

Të dhënat personale të dërguesve të vizatimeve do të përpunohen për qëllime të konkursit të vizatimit nga personat e përfshirë dhe të punësuar për zbatimin e tij.

Qëllimet e përpunimit të të dhënave personale të dërguesve të vizatimeve janë si më poshtë:

Emri dhe mbiemri - me qëllim që të mundësohet identifikimi dhe dallimi i dërguesve dhe vizatimeve të dërguara.

Data e lindjes - me qëllim të përcaktimit të së drejtës për pjesëmarrje në konkursin e vizatimit si dhe përcaktimin e përkatësisë në njërin nga dy kategoritë e moshave

Adresa – kërkohet për dërgimin e **letrës falënderuese** për pjesëmarrje në konkursin e vizatimit

Numri i telefonit të kontaktit – kërkohet për të informuar dërguesin nëse atij i është dhënë një nga çmimet e mësipërme

Dërguesit e vizatimeve (Subjektet e të dhënave personale) kanë të drejtë të kërkojnë informacion nga zbatuesi (agjencia e marketingut) në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

Kontrolluesi është i detyruar t'i japë përgjigje adekuate çdo pyetjeje lidhur me mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

Kontrolluesi ka të drejtë në qasjen e të dhënave personale të mbledhura në bazën e të dhënave. Në rast të një gabimi në publikimin e të dhënave personale, kontrolluesi ka të drejtë ta korrigjojë atë.

Afati i ruajtjes së të dhënave personale

Neni 10

Të dhënat personale dhe të gjitha vizatimet e dorëzuara që do të hyjnë në fazën e dytë të vlerësimit do të shkatërrohen nga agjencia e marketingut pas përfundimit dhe publikimit të rezultateve të konkursit të vizatimit për fëmijë me procesverbal në prani të një komisioni prej tre anëtarësh.

Vizatimet e shpërblyera, por jo dhe të dhënat personale të pjesëmarrësve të shpërblyer, do të mbahen të publikuara përgjithmonë në rrjetet sociale të Penzia.mk, ndërsa të gjitha vizatimet e tjera që hynë në përzgjedhjen e ngushtë, së bashku me të dhënat personale të dërguesve, do të shkatërrohen pas përfundimit dhe shpalljes së rezultateve të konkursit artistik për fëmijë me procesverbal në prani të një komisioni tre anëtarësh.

Rëndësia e rregullave të konkursit të vizatimit

Neni 11

Këto rregulla zyrtare janë të vlefshme që nga dita e miratimit të tyre dhe do të vlejnjë deri në përfundimin e konkursit të vizatimit për fëmijë. Duke marrë pjesë në konkursin e vizatimit, çdo pjesëmarrës pranon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këto rregulla dhe pranon përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale të përshkruara në këto rregulla.